



Republika Kosovo  
Republika e Kosovës  
Republic of Kosovo



Opština Zvečan  
Komuna e Zveçanit  
Municipality of Zvečan

На основу члана 12., 51. и 53. Закона о локалној самоуправи бр. 03/L-040 („Службени лист РК“ бр. 28/2008), члана 3. став 1. и члана 8. Административног упутства МЈС-а бр. 05/2020 о поступцима оснивања, саставу и надлежности сталних одбора, као и чланова 9, 29. став 1. и 31. Статута општине Звечан, а узимајући у обзир извршену оцену законитости претходне Одлуке о избору чланова Одбора за заједнице (број 020-121/2 од 05.03.2026. године), којом је од стране надлежног министарства указано на потребу усклађивања и наложено доношење новог акта, Скупштина општине Звечан, након претходног разматрања и гласања, на својој 1. (првој) ванредној седници у 2026. години, одржаној дана 07.04.2026. године, једногласно доноси:

## О Д Л У К У

### о формирању Одбора за заједнице

#### Члан 1.

Овом одлуком формира се **Одбор за заједнице** као стални одбор Скупштине општине Звечан.

#### Члан 2.

Одбор из члана 1. ове одлуке формира се у следећем саставу, и то:

1. Дијана Радовановић – чланица (жена, представница црногорске заједнице),
2. Инес Аљовић – чланица (жена, представница бошњачке заједнице),
3. Илир Пеци – члан (мушкарац, одборник Скупштине и представник албанске заједнице),
4. Предраг Радовановић – члан (мушкарац, одборник Скупштине),
5. Радомир Вучовић – члан (мушкарац, одборник Скупштине).

#### Члан 3.

Одбор за заједнице разматра питања из своје надлежности у складу са чланом 53. Закона бр. 03/L-040 о локалној самоуправи и одредбама Административног упутства МЈС-а број 05/2020 о поступцима оснивања, саставу и надлежности сталних одбора.

#### **Члан 4.**

Председника/председницу Одбора за заједнице бирају чланови Одбора већином гласова на првој конститутивној седници Одбора.

#### **Члан 5.**

Мандат чланова Одбора за заједнице траје колико и мандат одборника Скупштине општине, односно престаје престанком мандата одборника, у складу са важећим прописима и дефинисано је чланом 12. Административног упутства МЈС-а бр. 05/2020 о поступцима оснивања, саставу и надлежности сталних одбора.

#### **Члан 6.**

Одлука се доноси као нови, усклађени акт ради поступања по налогу надлежног министарства (број 020-121/2 од 05.03.2026. године) из поступка оцене законитости претходне одлуке.

Даном ступања на снагу ове одлуке престаје да важи претходна Одлука Скупштине општине Звечан о формирању Одбора за заједнице (број: Р-1-4/26, датум: 30.01.2026. године).

#### **Члан 7.**

Након усвајања од стране Скупштине општине Звечан, ова Одлука ступа на снагу 30 дана од слања надзорном органу, у смислу члана 8, у вези са чланом 9 Закона бр. 08/Л284 о управном преиспитивању општинских аката и 7 дана од јавног објављивања на огласној табли или званичној веб страници општине.

### ***Образложење***

Одлука о формирању Одбора за заједнице доноси се као нови, усклађени акт, ради поступања по налогу надлежног министарства, број 020-121/2 од 05.03.2026. године, датом у поступку оцене законитости претходно донете Одлуке Скупштине општине Звечан о формирању Одбора за заједнице.

Разлог за доношење ове одлуке огледа се у потреби да се питање формирања Одбора за заједнице уреди на јасан, потпун и са важећим прописима усклађен начин, у складу са Законом о локалној самоуправи, Статутом општине Звечан и одредбама Административног упутства МЈС-а број 05/2020 о поступцима оснивања, саставу и надлежности сталних одбора.

Овом одлуком се утврђује да Одбор за заједнице броји 5 чланова, у складу са чланом 31. став 2. Статута општине Звечан. Приликом утврђивања састава Одбора посебно је вођено рачуна да у његовом раду учествују све заједнице које живе у општини, чиме се обезбеђује

представљање интереса свих заједница и остварује сврха постојања овог тела као механизма за заштиту, промоцију и унапређење права заједница на локалном нивоу.

Истовремено, предложени састав Одбора је утврђен тако да је испуњен законски услов да просту већину чланова Одбора чине представници Скупштине општине Звечан, у складу са чланом 53.1 Закона о локалној самоуправи. Поред тога, састав Одбора је одређен и у складу са обавезом да већину чланова Одбора за заједнице чине припадници невећинских заједница, што је обезбеђено учешћем представника албанске, црногорске и бошњачке заједнице, сагласно закону и релевантном административном упутству.

Приликом предлагања и утврђивања састава Одбора вођено је рачуна и о томе да ово тело одражава родну равноправност, у складу са важећим законодавством, чиме се обезбеђује равноправна заступљеност и поштовање начела једнаких могућности у раду овог општинског тела.

Доношењем ове одлуке обезбеђује се законито и функционално образовање Одбора за заједнице као сталног тела Скупштине општине, које ће у оквиру својих надлежности разматрати питања од значаја за положај заједница, давати препоруке и доприносити институционалној заштити права свих заједница које живе на територији општине Звечан.

Имајући у виду да се овом одлуком на потпун и усклађен начин уређује материја која је била предмет претходне одлуке, предвиђено је да даном ступања на снагу ове одлуке престаје да важи Одлука Скупштине општине Звечан о формирању Одбора за заједнице, број Р-1-4/26 од 30.01.2026. године.

Из свих наведених разлога, предложено је да Скупштина општине Звечан донесе Одлуку о формирању Одбора за заједнице као у диспозитиву.

Представљајући Скупштине општине  
Звечан  
  
Др Срђан Милосављевић





Republika Kosovo  
Republika e Kosovës  
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO			
KOMUNA E ZVEÇANIT OPŠTINA ZVEČAN ZVEČAN MUNICIPALITY			
Njësia Org. Org. Jedin. Org. Unit.	CO	Nr. Prot. Br. Prot. Prot.Nr.	B-1-3/26
Nr. i faqeve Br. stranica No. pages	3	Data Datumi Date	07.04.2026



Opština Zvečan  
Komuna e Zveçanit  
Municipality of Zvečan

Në bazë të neneve 12, 51 dhe 53 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040 ("Gazeta Zyrtare e RK" nr. 28/2008), nenit 3 paragrafi 1 dhe nenit 8 të Udhëzimit Administrativ të MAPL-së nr. 05/2020 për procedurat e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme, si dhe të neneve 9, 29 paragrafi 1 dhe 31 të Statutit të Komunës së Zveçanit, duke marrë parasysh vlerësimin e ligjshmërisë së Vendimit paraprak për zgjedhjen e anëtarëve të Komitetit për Komunitete (numër 020-121/2, datë 05.03.2026), me të cilin nga ministria kompetente është theksuar nevoja për harmonizim dhe është urdhëruar nxjerrja e një akti të ri, Kuvendi i Komunës së Zveçanit, pas shqyrtimit paraprak dhe votimit, në mbledhjen e tij të 1-rë (parë) të jashtëzakonshme në vitin 2026, të mbajtur më 07.04.2026, me votim unanim miraton:

## V E N D I M

### për formimin e Komitetit për Komunitete

#### Neni 1.

Me këtë vendim formohet Komiteti për Komunitete si komitet i përhershëm i Kuvendit të Komunës së Zveçanit.

#### Neni 2.

Komiteti nga neni 1 i këtij vendimi formohet në këtë përbërje, si vijon:

1. Dijana Radovanović – anëtare (femër, përfaqësuese e komunitetit malazez),
2. Ines Aljović – anëtare (femër, përfaqësuese e komunitetit boshnjak),
3. Ilir Peci – anëtar (mashkull, anëtar i Kuvendit dhe përfaqësues i komunitetit shqiptar),
4. Predrag Radovanović – anëtar (mashkull, anëtar i Kuvendit),
5. Radomir Vučović – anëtar (mashkull, anëtar i Kuvendit).

#### Neni 3.

Komiteti për Komunitete i shqyrton çështjet nga kompetenca e tij në përputhje me nenin 53 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale dhe me dispozitat e Udhëzimit Administrativ të MAPL-së nr. 05/2020 për procedurat e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme.

#### **Neni 4.**

Kryesuesin/kryesuesen e Komitetit për Komunitete e zgjedhin anëtarët e Komitetit me shumicë votash në mbledhjen e parë konstituive të Komitetit.

#### **Neni 5.**

Mandati i anëtarëve të Komitetit për Komunitete zgjat aq sa mandati i anëtarëve të Kuvendit të Komunës, përkatësisht përfundon me përfundimin e mandatit të anëtarëve të Kuvendit, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe është përcaktuar me nenin 12 të Udhëzimit Administrativ të MAPL-së nr. 05/2020 për procedurat e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteve të përhershme.

#### **Neni 6.**

Vendimi nxirret si akt i ri, i harmonizuar, për veprim sipas urdhrimit të ministrisë kompetente (numër 020-121/2, datë 05.03.2026) nga procedura e vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit paraparak.

Ditën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi pushon së vlefshmi Vendimi paraparak i Kuvendit të Komunës së Zveçanit për formimin e Komitetit për Komunitete (numër: P-1-4/26, datë: 30.01.2026).

#### **Neni 7.**

Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Zveçanit, ky Vendim hyn në fuqi 30 ditë nga dërgimi te organi mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me nenin 9 të Ligjit nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve Komunale, si dhe 7 ditë nga publikimi publik në tabelën e shpalljeve ose në faqen zyrtare të internetit të komunës.

#### ***Arsyetim***

Vendimi për formimin e Komitetit për Komunitete nxirret si akt i ri, i harmonizuar, për veprim sipas urdhrimit të ministrisë kompetente, numër 020-121/2, datë 05.03.2026, të dhënë në procedurën e vlerësimit të ligjshmërisë së Vendimit të nxjerrë më herët nga Kuvendi i Komunës së Zveçanit për formimin e Komitetit për Komunitete.

Arsyeja për nxjerrjen e këtij vendimi qëndron në nevojën që çështja e formimit të Komitetit për Komunitete të rregullohet në mënyrë të qartë, të plotë dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, në përputhje me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Statutin e Komunës së Zveçanit dhe dispozitat e Udhëzimit Administrativ të MAPL-së nr. 05/2020 për procedurat e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteve të përhershme.

Me këtë vendim përcaktohet se Komiteti për Komunitete ka 5 anëtarë, në përputhje me nenin 31 paragrafi 2 të Statutit të Komunës së Zveçanit. Gjatë përcaktimit të përbërjes së Komitetit është pasur

kujdes të veçantë që në punën e tij të marrin pjesë të gjitha komunitetet që jetojnë në komunë, me ç'rast sigurohet përfaqësimi i interesave të të gjitha komuniteteve dhe realizohet qëllimi i ekzistimit të këtij organi si mekanizëm për mbrojtjen, promovimin dhe avancimin e të drejtave të komuniteteve në nivel lokal.

Njëkohësisht, përbërja e propozuar e Komitetit është përcaktuar në atë mënyrë që të plotësohet kushti ligjor që shumicën e thjeshtë të anëtarëve të Komitetit ta përbëjnë përfaqësuesit e Kuvendit të Komunës së Zveçanit, në përputhje me nenin 53.1 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale. Përveç kësaj, përbërja e Komitetit është përcaktuar edhe në përputhje me detyrimin që shumicën e anëtarëve të Komitetit për Komunitete ta përbëjnë pjesëtarët e komuniteteve joshumicë, gjë që është siguruar me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të komunitetit shqiptar, malazez dhe boshnjak, në pajtim me ligjin dhe udhëzimin administrativ përkatës.

Gjatë propozimit dhe përcaktimit të përbërjes së Komitetit është pasur parasysh edhe fakti që ky organ të pasqyrojë barazinë gjinore, në përputhje me legjislacionin në fuqi, me ç'rast sigurohet përfaqësimi i barabartë dhe respektimi i parimit të mundësive të barabarta në punën e këtij organi komunal.

Me nxjerrjen e këtij vendimi sigurohet formimi i ligjshëm dhe funksional i Komitetit për Komunitete si organ i përhershëm i Kuvendit të Komunës, i cili, në kuadër të kompetencave të tij, do të shqyrtojë çështje me rëndësi për pozitën e komuniteteve, do të japë rekomandime dhe do të kontribuojë në mbrojtjen institucionale të të drejtave të të gjitha komuniteteve që jetojnë në territorin e Komunës së Zveçanit.

Duke pasur parasysh se me këtë vendim rregullohet në mënyrë të plotë dhe të harmonizuar materia që ka qenë objekt i vendimit paraprak, është paraparë që, ditën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, të pushojë së vlefshmi Vendimi i Kuvendit të Komunës së Zveçanit për formimin e Komitetit për Komunitete, numër P-1-4/26, datë 30.01.2026.

Për të gjitha arsyet e lartshënuara, është propozuar që Kuvendi i Komunës së Zveçanit të nxjerrë Vendimin për formimin e Komitetit për Komunitete si në dispozitiv.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së  
Zveçanit



Dr. Srdan Milosavljević